



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI KOMISIONERI

Nr. 723/9 Prot.

Tiranë, më 10. 07 . 2026

V E N D I M

Nr. 191, datë 10. 07. 2026

Bazuar në nenin 32 dhe nenin 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 93, datë 21.04.2026, me ankues z. E. Xh.,¹ kundër Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, me pretendimin për diskriminim, për shkak të “gjendjes shëndetësore” dhe “aftësisë së kufizuar ”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues E. Xh., i biri i A. dhe i T., i datëlindjes 27.02.1955, lindur në Zenisht-Mat, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, si dhe fermer i regjistruar me NIPT M17526972W, në kuadër të marrëdhënies kontraktore të lidhur me Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR), pretendon se ka qenë subjekt i një trajtimi diskriminues për shkak të gjendjes së tij shëndetësore dhe statusit të lidhur me aftësinë e kufizuar/invaliditetin.

Në këtë kuadër, ankuesi sqaron se ka lidhur kontratë me AZHBR-në me nr. 280 prot., datë 15.01.2025, me afat deri më 30.06.2025, në kuadër të një granti për blerjen e një traktori dhe freze bujqësore. Sipas Aneksit 2 të kontratës, vlera e investimit përcaktohej në 2.232.202 lekë për traktorin bujqësor dhe 276.556 lekë për frezën bujqësore, me një total prej 2.508.758 lekë. Ankuesi pretendon se ka përmbushur detyrimet kontraktore duke realizuar blerjen e pajisjeve sipas kushteve të kontratës dhe ka pritur verifikimin dhe pagesën përkatëse nga ana e AZHBR-së.

¹ Përfaqësuar nga Av. E. B., sipas Prokurës së Posaçme nr.1101 rep., nr.518 kol., datë 20.04.2026.

² Në vijim do t'i referohemi me akronimin: KMD.

Gjatë procedurës administrative, AZHBR i është drejtuar ankuesit me shkresën nr. 280/9, datë 18.09.2025, duke kërkuar sqarime lidhur me “vërtetimin e invaliditetit” dhe “vërtetimin e aftësisë për punë”. Ankuesi ka paraqitur shpjegimet e tij dhe dokumentacionin përkatës, duke sqaruar se në kohën e aplikimit kishte status invaliditeti për shkak të problemeve shëndetësore kardiologjike, por më pas, pas rikomisionimit, është shpallur i aftë për punë, çka provohet edhe nga dosja mjekësore me nr. 120044/330, e konfirmuar me vërtetim të datës 11.10.2025.

Megjithatë, me shkresën nr. 280/18, datë 24.12.2025, të njoftuar më 26.12.2025, AZHBR ka refuzuar kërkesën për pagesë, duke e arsyetuar refuzimin me faktin se ankuesi është përfitues i statusit të “invaliditetit”.

Ankuesi pretendon se ky refuzim përbën trajtim të padrejtë dhe diskriminues për shkak të gjendjes shëndetësore, duke argumentuar se legjislacioni shqiptar nuk ndalon personat me aftësi të kufizuara apo me status invaliditeti të ushtrojnë veprimtari ekonomike, përfshirë aktivitetin bujqësor, dhe se në rastin konkret nuk ekziston asnjë akt mjekësor ndalues apo bazë ligjore që justifikon përjashtimin e tij nga përfitimi i grantit.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi:

1. Në respektim të ligjit, kërkoj që të deklaroni se jam diskriminuar dhe, në bazë të ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, të shqyrtoni ankesën time dhe të vendosni se jam diskriminuar, si dhe t’i kërkon AZHBR-së të mos më diskriminojë dhe të rregullojë pasojat e ardhura nga ky diskriminim.
2. Gjithashtu kërkoj detyrimin e AZHBR-së për të mundësuar pagesën sipas kontratës nr. 280/1 prot., datë 15.01.2025, në vlerën 50% të detyrimit total, shumë e cila përcaktohet qartë në aneksin e kontratës.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, sipas përmbajtjes në vijim: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: *“‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Në bazë të nenit 7, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Ligjin 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Bazuar në nenin 32/1/a të LMD-së, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe. Përsa më lart, referuar nenit 33, të këtij Ligji, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, si dhe ato çështje që janë brenda afatit kohor për shqyrtim sipas parashikimeve të LMD-së.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën nr. 723/2 prot., datë 27.04.2026, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në kuadër të shqyrtimit të ankesës nr. 93 regj., datë 21.04.2026, të paraqitur nga z. E. Xh., kundër Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, me pretendimin për diskriminim për shkak të “gjendjes shëndetësore” dhe “aftësisë së kufizuar”, i ka kërkuar kësaj të fundit parashtrime me shkrim, si dhe informacion dhe dokumentacion të plotë në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi, duke përfshirë bazën ligjore dhe nënligjore të skemës së grantit, kriteret e pranueshmërisë dhe vlerësimit, dokumentacionin e aplikimit dhe të kontratës nr. 280/1 prot., datë 15.01.2025, arsyetimin e refuzimit të pagesës sipas shkresës nr. 280/18, datë 24.12.2025, si dhe çdo akt tjetër administrativ apo rregullator mbi të cilin është mbështetur vendimmarrja e saj.
- Me shkresën nr. 2407/1 prot., datë 11.05.2026, Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, administruar pranë institucionit të Komisionerit me nr. 723/3 prot., datë 12.05.2026, ka kthyer përgjigje Komisionerit, duke depozituar parashtrime me shkrim, informacion shpjegues dhe dokumentacionin përkatës në lidhje me procedurën e aplikimit, lidhjen dhe zbatimin e kontratës nr. 280/1 prot., datë 15.01.2025, si dhe

vendimmarrjen për refuzimin e kërkesës për pagesë të ankuesit. Në këtë shkresë institucioni sqaron se:

Bazuar në VKM nr. 130 prot., datë 06.03.2024, “Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2024”, Udhëzimin nr. 6, datë 07.03.2024, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 22, datë 19.09.2024, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 6, datë 7.3.2024 ‘Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural’”, subjekti E. Xh., me NIPT fermeri , NIPT M17526972W ka aplikuar për mbështetje financiare në kuadër të programit të mbështetjes të Skemave Kombëtare 2024, me aplikimin nr. 3468 prot., datë 04.11.2024, për masën 12 “Për blerjen e traktorëve, makinerive dhe pajisjeve për mekanizimin dhe modernizimin e proceseve të punës në fermat bujqësore dhe blegtorale. Masa e përfitimit të jetë në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 5,000,000 (pesë milion) lekë për subjekt”.

Referuar sa më sipër, kriteret, procedurat dhe mënyra e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe të Ministrit të Financave, konkretisht në Udhëzimin nr. 6, datë 07.03.2024, të ndryshuar.

Në bazë të parashikimeve të mësipërme, subjekti E. Xh., ka lidhur me AZHBR kontratën e grantit nr. 280/1 prot., datë 15.01.2025, me objekt: Blerje traktori dhe frezë bujqësore. Në kreun “Kriteret specifike të përfitimit, kriteret konkurruese dhe dokumentacioni” të udhëzimit të sipërcituar, për masën 12, përfituesit e mundshëm përfshijnë: Fermer individual, subjekt me status fizik/juridik, SHBB. Aplikanti, me status person fizik/juridik, duhet të jetë i regjistruar për fushën e veprimtarisë së pranueshme për të cilën aplikon në Qendrën Kombëtare të Biznesit si dhe me status aktiv. Në këtë masë mund të aplikojnë fermat të cilat kryejnë aktivitet bujqësor me sipërfaqe minimale toke bujqësore jo më pak se 1 (një) ha, si dhe fermat blegtorale me kapacitet jo më pak se 10 (dhjetë) lopë, jo më pak se 100 (njëqind) të imta, jo më pak se 10 (dhjetë) dosa dhe jo më pak se 10,000 (dhjetë mijë) shpendë.

Në përputhje me kriteret e skemës mbështetëse, përfituesi duhet të ushtrojë veprimtari ekonomike në përputhje me legjislacionin në fuqi. Z. E. Xh., ka aplikuar si fermer individual. Referuar legjislacionit në fuqi, “Fermer quhet një individ që është banor atje ku zotëron tokë bujqësore në pronësi ose në përdorim; zhvillon aktivitetin në një sipërmarrje bujqësore, si veprimtari për prodhimin e produkteve bujqësore, bimore ose shtazore, i vetëpunësuar në tokën e tij; dhe nuk është i regjistruar si person fizik ose juridik në QKB. Fermeri regjistrohet si i tillë në Drejtorinë Rajonale Tatimore. Fermeri ka detyrime për të paguar Kontribute Vjetore të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore”.

Gjithashtu, në udhëzim janë të përcaktuara dokumentet që duhet të depozitohet subjekti i kontraktuar për masën 12, në momentin e dorëzimit të kërkesës për pagesë, ku një ndër dokumentet e përcaktuara është: j) Vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria e Tatimeve që vërteton se aplikanti ka përmbushur detyrimet. Për fermerët individualë vërtetim për shlyerjen e

sigurimeve shoqërore nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore. Ky dokument duhet të jetë lëshuar jo më parë se 30 ditë nga data e dorëzimit të kërkesës për pagesë; g) Vërtetimin e bankës për numrin e llogarisë bankare, me firmë dhe vulë të njomë.

Referuar nenit 5 pika 3 të kontratës së grantit, përfituesi ishte i detyruar të përfundonte investimin e përmendur në nenin 1 të kësaj kontrate dhe të paraqiste kërkesën për pagesë dhe të gjitha dokumentet e kërkuara jo më vonë se data 30.06.2025. Në vijim të paraqitjes së kërkesës për pagesë, AZHBR ka kryer verifikimin administrativ të dokumentacionit në zbatim të Udhëzimit nr. 22, datë 19.09.2024 “Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural”, si dhe të dispozitave të kontratës së grantit.

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit është konstatuar se subjekti, në vend të dokumentit të kërkuar nga Drejtoria e Tatimeve dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore mbi përmbushjen e detyrimeve përkatëse, ka paraqitur “Vërtetim për lloj dhe masë pensioni”, ku rezulton se përfiton pension me llojin “Invaliditet Urban”.

AZHBR ka njoftuar subjektin për mangësitë dhe mosplotësimin e kërkesave dokumentare me shkresën nr. 280/5 Prot., datë 09.06.2025, duke i lënë afat për plotësimin dhe sqarimin e tyre.

Referuar nenit 5 të kontratës së grantit “Detyrimet e Përfituesit”, përfituesi është i detyruar të paraqesë informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar nga AZHBR.

Pas kërkesës për sqarim nga AZHBR, subjekti E. Xh., fillimisht me shkresën nr. 280/6 prot., datë 17.06.2025, ka dorëzuar dublikate të vendimit të KMCAP nr. 27.02.2020 me shënimin “i paaftë për punë”. Më pas, me shkresën nr. 280/8 prot., datë 25.08.2025, ka dorëzuar një vërtetim me nr. regjistri 1314, datë 01.09.2025, nga mjeku i familjes me shënimin: “I aftë për punë”. Ndodhur përpara fakteve dhe dokumenteve kontradiktore dhe në kuadër të një hetimi të plotë administrativ, AZHBR i është drejtuar MSHMS dhe Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor me kërkesën nr. 4707 prot., datë 12.12.2025, “Kërkesë për informacion/konfirmim”, duke kërkuar verifikim dhe konfirmim për rastin konkret nëse subjekti E. Xh., do të konsiderohet i aftë për punë.

Nga përgjigja e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor (shkresa nr. 4707/11 prot., datë 24.12.2025, “Kthim përgjigje”), rezulton se statusi i invaliditetit të subjektit vijon të jetë në fuqi dhe çdo ndryshim mbi aftësinë për punë është kompetencë e KMCAP-it. Vërtetimi i aftësisë për punë i lëshuar nga mjeku i familjes është i pavlefshëm dhe shtetasi Z. Xh., konsiderohet ligjërisht i paaftë për punë.

Mbështetur sa më sipër dhe në nenin 6 të kontratës “Të drejtat e AZHBR-së”, ku përcaktohet se AZHBR ka të drejtë të kërkojë dokumentacion shtesë dhe të refuzojë autorizimin e pagesës në rast se përfituesi nuk paraqet dokumentacionin e nevojshëm brenda afatit të përcaktuar, kërkesa për pagesë e subjektit është refuzuar me shkresën nr. 280/18, datë 24.12.2025, “Njoftim mbi refuzimin e kërkesës për pagesë”. Vlerësimi administrativ është kryer vetëm mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur, përputhshmërisë së tij me kriteret e skemës sipas

udhëzimit të sipërcituar dhe detyrimeve kontraktore të përfituesit. Gjithashtu, sqarojmë se për shkak të mosplotësimit të këtyre kritereve, nga AZHBR është refuzuar kërkesa për pagesë edhe për aplikantë të tjerë.

Për sa më sipër, vlerësojmë se nuk ndodhemi përpara elementeve të diskriminimit në kuptim të ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, të ndryshuar, por përpara një procesi të rregullt administrativ verifikimi të dokumentacionit dhe përmbushjes së kushteve të përcaktuara në skemën mbështetëse dhe kontratën e grantit.

- Me shkresën nr. 723/4 prot., datë 13.05.2026, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi i ka përcjellë përfaqësuesit ligjor të ankuesit av. Eduart Brahilika dhe vetë ankuesit z. E. Xh., shkresën nr. 2407/1 prot., datë 11.05.2026 të AZHBR-së, duke i njoftuar njëkohësisht të drejtën për të paraqitur parashtrime dhe kundërshtime brenda afatit 10 (dhjetë) ditor nga marrja dijeni.
- Me shkresën nr. 723/5 prot., datë 26.05.2026, të administruar pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, subjekti ankues z. E. Xh., ka paraqitur parashtrimet e tij me shkrim, nëpërmjet të cilave ka kundërshtuar qëndrimin dhe parashtrimet e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, duke i qëndruar pretendimeve të ngritura në ankesë për diskriminim dhe duke argumentuar se refuzimi i pagesës nuk ka bazë ligjore dhe përbën trajtim të padrejtë për shkak të gjendjes së tij shëndetësore dhe aftësisë së kufizuar.
- Me shkresën nr. 723/6 prot., datë 15.06.2026, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në vijim të procedurës administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 93 regj., datë 21.04.2026, i ka kërkuar Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural informacion dhe sqarime shtesë lidhur me bazën ligjore dhe faktike të refuzimit të kërkesës për pagesë, duke kërkuar të specifikohet nëse legjislacioni dhe aktet nënligjore të zbatueshme parashikojnë si kusht aftësinë për punë të aplikantit, qëllimin e kërimit të dokumentacionit mbi sigurimet shoqërore, raportin ndërmjet statusit të invaliditetit dhe përfitimit të grantit, bazën ligjore të çdo vlerësimi të lidhur me pensionin e invaliditetit, si dhe nëse personat përfitues të pensioneve përjashtohen nga e drejta për të aplikuar ose përfituar nga skemat mbështetëse të AZHBR-së.
- Me shkresën nr. 2407/4 prot., datë 15.06.2026, Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural i është përgjigjur Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, duke paraqitur shpjegimet dhe argumentet e saj lidhur me refuzimin e kërkesës për pagesë të grantit në kuadër të Masës 12 për z. E. Xh., si dhe bazën faktike dhe ligjore mbi të cilën është mbështetur ky vendimmarrje, ku ndër të tjera sqaron se:

Argumenti kryesor është se z. Xh., mban prej vitit 2020 një vendim të përhershëm nga Komisioni Mjekësor që e deklaron të paaftë të plotë dhe të përhershëm për punë. Pikërisht për këtë arsye ai përfiton pension invaliditeti të plotë. AZHBR-ja vlerëson se është kontradiktore që dikush i njohur ligjërisht si i paaftë për punë të pretendojë se ushtron aktivitet ekonomik bujqësor aktivitet ky që në thelb kërkon aftësi fizike për punë.

Megjithëse asnjë dispozitë e VKM-së apo udhëzimeve nuk e kërkon shprehimisht “aftësinë për punë” si kriter formal, AZHBR-ja argumenton se ky kusht është i nënkuptuar nga vetë qëllimi i skemës: Masa 12 financon investime që shërbejnë për ushtrimin real të aktivitetit bujqësor, jo blerje formale të mjeteve bujqësore. Prandaj, sipas AZHBR-së, statusi i invaliditetit nuk krijon automatikisht përjashtim, por në këtë rast konkret krijon një mospërputhje mes profilit të aplikantit dhe qëllimit të grantit.

Sa i përket procedurës, AZHBR-ja sqaron se refuzimi nuk erdhi nga mungesa e dokumenteve, por nga vetë dokumentet e dorëzuara të cilat zbuluan dhe konfirmuan statuse të ndryshme të aplikantit atij të invaliditetit të plotë dhe të përhershëm dhe Raportit Mjekësor i aftë për punë nëpërmjet dy institucioneve të ndryshme shëndetësore.

- Me shkresën nr. 1069/1 prot., datë 30.06.2026, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në kuadër të procedurës administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 93, regj., datë 21.04.2026, i ka kërkuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore, informacion dhe sqarime institucionale lidhur me statusin ligjor të personave përfitues të pensionit të invaliditetit të plotë ose të pjesshëm, të regjistruar si fermerë me NIPT aktiv, përkatësisht mbi të drejtën e tyre për të ushtruar veprimtari ekonomike dhe detyrimin për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.
- Me shkresën nr. 10089/1 prot., datë 03.07.2026, administruar pranë institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi me nr. 1069/2 prot., datë 06.07.2026, institucioni ka informuar, ndër të tjera, se:

Instituti i Sigurimeve Shoqërore sqaron se regjistrimi i një veprimtarie ekonomike si person fizik, person juridik ose fermer me NIPT rregullohet nga legjislacioni për biznesin dhe procedurat tatimore, ndërsa e drejta për përfitimin e pensionit të invaliditetit rregullohet nga Ligji nr. 7703/1993 "Për Sigurimet Shoqërore".

Sipas nenit 57 të këtij ligji, përfitimet e sigurimeve shoqërore kanë për qëllim të zëvendësojnë të ardhurat e humbura nga puna. Për këtë arsye, përfituesi nuk ka të drejtë të marrë pension invaliditeti gjatë periudhës kur është i punësuar ose ushtron veprimtari ekonomike si i vetëpunësuar, përveç rasteve kur ligji e lejon shprehimisht. Për personat me pension invaliditeti të plotë, të cilët janë shpallur nga KMCAP të paaftë për çdo veprimtari ekonomike, punësimi ose vetëpunësimi bie në kundërshtim me kushtet mbi të cilat është dhënë pensioni. Si rrjedhojë, nëse këta persona ushtrojnë aktivitet ekonomik ose punësohen, ata nuk kanë të drejtë të përfitojnë këstet mujore të pensionit të invaliditetit. Ndërsa personat me pension invaliditeti të pjesshëm mund të regjistrohen si person fizik i vetëpunësuar ose fermer me NIPT dhe të vazhdojnë të përfitojnë pensionin, vetëm nëse respektojnë kushtet e përcaktuara nga KMCAP lidhur me shkallën e invaliditetit, llojin e punës dhe orarin e punës. Ligji parashikon shprehimisht që, në këto raste, ushtrimi i aktivitetit ekonomik nuk sjell ndërprerjen e pensionit.

Prandaj, regjistrimi në organet tatimore nuk është i mjaftueshëm për të përcaktuar të drejtën e përfitimit të pensionit. Për invalidët e plotë, ushtrimi i aktivitetit ekonomik sjell ndërprerjen

e pensionit, ndërsa për invalidët e pjesshëm, vazhdimi i përfitimit kushtëzohet nga respektimi i kufizimeve dhe përcaktimeve të bëra nga KMCAP.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë dhe më pak të favorshëm.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 1 dhe nenin 3/1, parashikojnë se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të pa drejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”.*

LMD, në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacionin në përmbushjen e detyrave të tij”.*

Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve, gëzon një mbrojtje të veçantë në kuadër të Kreut IV, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Konkretisht në nenin 20, pikat 1 dhe 2, të po këtij ligji, përcaktohet se: *“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato:*

- a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;*
- b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.*

2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për:

c) kontributin dhe mundësinë për të përfituar të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun”.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Nga analizimi i dokumentacionit të dërguar pranë KMD-së, rezulton se:

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (në vijim AZHBR) është krijuar dhe ushtron veprimtarinë e vet si Agjencia e Pagesave, në kuptim të nenit 21 të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007 “Për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural” të ndryshuar, dhe sipas përcaktimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 719, datë 31.10.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural”, të ndryshuar.

Sipas VKM nr. 719/2014, AZHBR është në formën e një personi juridik publik në varësi të Ministrit të Bujqësisë dhe ofron shërbime të drejtpërdrejta për fermerët vendas dhe zbaton politikat shtetërore për zhvillimin bujqësor dhe rural në Republikën e Shqipërisë.

Mbi po të njëjtën bazë, AZHBR është përgjegjëse për administrimin e fondeve të programeve për bujqësinë dhe ka për detyrë të vërë në zbatim masat e politikave bujqësore dhe zhvillimit rural, si më poshtë: a) Fondet e buxhetit të shtetit, b) Fondet Kunderparti, të Projektit 2KR, c) Fondet e Bashkimit Europian, d) Fonde të siguruara nga shtete dhe organizma të tjerë me qëllim zhvillimin bujqësor, si dhe masa të tjera të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore, me qëllim zhvillimin rural në Shqipëri.

Bazuar në VKM nr. 130 prot., datë 06.03.2024 “Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2024”, Udhëzimin nr. 6, datë 07.03.2024, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 22, datë 19.09.2024, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 6, datë 7.3.2024 ‘Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural’”, subjekti E. Xh., me NIPT fermeri M17526972E, ka aplikuar për mbështetje financiare në kuadër të programit të mbështetjes të Skemave Kombëtare 2024, me aplikimin nr. 3468 prot., datë 04.11.2024, për masën 12 “Për blerjen e traktorëve, makinerive dhe pajisjeve për mekanizimin dhe modernizimin e proceseve të punës në fermat bujqësore dhe blegtorale. Masa e përfitimit të jetë në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 5,000,000 (pesë milion) lekë për subjekt”.

Referuar sa më sipër, kriteret, procedurat dhe mënyra e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Bujqësisë

dhe Zhvillimit Rural dhe të Ministrit të Financave, konkretisht në Udhëzimin nr. 6, datë 07.03.2024, të ndryshuar.

Subjekti ankues E. Xh., ka lidhur me Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR) kontratën e grantit nr. 280/1 prot., datë 15.01.2025, me objekt “Blerje traktori dhe frezë bujqësore”, në kuadër të Skemave Kombëtare të Mbështetjes 2024, të miratuara me VKM nr. 130, datë 06.03.2024 “Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2024”, si dhe Udhëzimit nr. 6, datë 07.03.2024, të ndryshuar me Udhëzimin nr. 22, datë 19.09.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 6, datë 7.3.2024 ‘Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural’”.

Sipas parashikimeve të Udhëzimit nr. 6, datë 07.03.2024, të ndryshuar, për masën 12 “Për blerjen e traktorëve, makinerive dhe pajisjeve për mekanizimin dhe modernizimin e proceseve të punës në fermat bujqësore dhe blegtorale”, të ndryshuar, përfituesit duhet të përmbushin kriteret specifike të përcaktuara në kreun përkatës, si dhe të paraqesin dokumentacionin e kërkuar në momentin e kërkesës për pagesë, përfshirë vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria e Tatimeve dhe, për fermerët individualë, vërtetimin për shlyerjen e sigurimeve shoqërore nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, jo më të vjetër se 30 ditë nga data e dorëzimit të kërkesës për pagesë, si dhe vërtetimin e bankës për numrin e llogarisë bankare, me firmë dhe vulë të njomë.

Në zbatim të kontratës së grantit nr. 280/1 prot., datë 15.01.2025, dhe konkretisht nenit 5 pika 3 të saj, përfituesi është i detyruar të përfundojë investimin dhe të paraqesë kërkesën për pagesë së bashku me dokumentacionin e plotë jo më vonë se data 30.06.2025. Gjithashtu, në nenin 6 të kontratës “Të drejtat e AZHBR-së” parashikohet e drejta e institucionit për të kërkuar dokumentacion shtesë dhe për të refuzuar autorizimin e pagesës në rast se përfituesi nuk paraqet dokumentacionin e nevojshëm brenda afateve të përcaktuara.

Nga shqyrtimi administrativ i kryer nga AZHBR në zbatim të Udhëzimit nr. 22, datë 19.09.2024 “Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural”, si dhe dispozitave kontraktore të sipërcituara, rezulton se në momentin e kërkesës për pagesë, ankuesi nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar nga Drejtoria e Tatimeve dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për përmbushjen e detyrimeve ligjore, por ka depozituar “Vërtetim për lloj dhe masë pensioni”, ku evidentohet përfitimi i pensionit me status “Invaliditet Urban”.

Në vijim, AZHBR, me shkresën nr. 280/5 prot., datë 09.06.2025, ka njoftuar subjektin për mangësitë dokumentare dhe i ka lënë afat për plotësimin dhe sqarimin e tyre, në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr. 6, datë 07.03.2024, të ndryshuar dhe kontratës së grantit.

Pas këtij njoftimi, subjekti ka depozituar dokumentacion të ndryshëm, përfshirë vendimin e KMCAP-së nr. 27.02.2020 me shënimin “i paaftë për punë” dhe më pas një vërtetim të mjekut të familjes me shënimin “i aftë për punë”. Në kushtet e ekzistencës së dokumenteve kontradiktore, AZHBR, në ushtrim të kompetencave të saj dhe në zbatim të detyrimeve të

përcaktuara në Udhëzimin nr. 22, datë 19.09.2024 dhe kontratën e grantit, i është drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor me shkresën nr. 4707 prot., datë 12.12.2025, për verifikimin e statusit të aftësisë për punë të subjektit.

Me përgjigjen e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor (shkresa nr. 470711 prot., datë 24.12.2025), është konfirmuar se statusi i invaliditetit të subjektit vijon të jetë në fuqi, se çdo ndryshim mbi aftësinë për punë është kompetencë e KMCAP-it, dhe se vërtetimi i mjekut të familjes nuk ka vlerë juridike për përcaktimin e aftësisë për punë, duke u konsideruar subjekti ligjërisht i paaftë për punë.

Në përfundim të procedurës administrative, në zbatim të nenit 6 të kontratës së grantit dhe dispozitave të Udhëzimit nr. 22, datë 19.09.2024, AZHBR ka vendosur refuzimin e kërkesës për pagesë me shkresën nr. 280/18, datë 24.12.2025, “Njoftim mbi refuzimin e kërkesës për pagesë”, me arsyetimin se nuk është paraqitur dokumentacioni i plotë dhe i vlefshëm sipas kërkesave të skemës dhe kontratës, si dhe për shkak të mospërputhjeve të konstatuara në dokumentacionin e paraqitur lidhur me statusin e aftësisë për punë.

Nga analiza e praktikës administrative dhe e kuadrit ligjor e nënligjor të sipërcituar, rezulton se vendimmarrja e AZHBR-së është mbështetur në zbatimin e Udhëzimit nr. 6, datë 07.03.2024, të ndryshuar me Udhëzimin nr. 22, datë 19.09.2024, si dhe në kontratën e grantit nr. 280/1 prot., datë 15.01.2025, konkretisht nenin 5 dhe nenin 6 të saj, duke u bazuar në verifikimin e përmbushjes së kriterëve dokumentare dhe detyrimeve kontraktore të përfituesit.

Referuar arsytimit dhe analizës së bërë AZHBR sqaron se, në përputhje me kriteret e skemës mbështetëse, përfituesi duhet të ushtrojë veprimtari ekonomike në përputhje me legjislacionin në fuqi. Z. E. Xh., ka aplikuar si fermer individual. Fermeri ka detyrime për të paguar Kontribute Vjetore të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore dhe konkretisht nga Udhëzimi nr. 6, i cituar në dokument, si kriter specifik përfitimi. Aplikanti, me status person fizik/juridik, duhet të jetë i regjistruar për fushën e veprimtarisë prodhuese për të cilën aplikon në Qendrën Kombëtare të Biznesit ose si në rastin konkret në Tatime si dhe të jetë me status aktiv. AZHBR-ja thekson se personat me invaliditet nuk përjashtohen automatikisht nga skemat e mbështetjes çka do të thotë se nuk ekziston asnjë trajtim kategorial i ndryshëm. Refuzimi i Z. Xh., nuk vjen nga fakti se është invalid, por nga fakti se organi kompetent ka deklaruar se ai konkretisht nuk mund të ushtrojë asnjë veprimtari ekonomike pasi përfiton pension invaliditeti të plotë dhe të përhershëm.

Referuar dispozitave të VKM nr. 130/2024 dhe Udhëzimit nr. 6/2024 apo Udhëzimit nr. 22/2024 nuk parashikon shprehimisht aftësinë për punë si kriter përjashtues për Masën 12 por AZHBR-ja e ka ndërtuar këtë kufizim nëpërmjet interpretimit.

Ndërkohë, nga ana e ankuesit janë paraqitur dy dokumente të kundërta: vendimin e KMCAP-it (*i paaftë për punë*) dhe vërtetimin e mjekut të familjes (*i aftë për punë*). Ndodhur në këto kushte, AZHBR-ja nga ana e saj i është drejtuar Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit

Shëndetësor për verifikim. Përgjigja konfirmoi se vërtetimi i mjekut të familjes nuk ka vlerë juridike për aftësinë për punë kjo kompetencë i takon vetëm KMCAP-së.

Nga ana tjetër, referuar Ligjit nr. 9817/2007 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural” të ndryshuar, nuk jep një përkufizim të shprehur të “fermerit” si person fizik, por e trajton atë indirekt nëpërmjet konceptit të “fermës” dhe të “përfituesve”. Fermë quhet njësi ekonomike me bazë një sipërfaqe toke me veprimtari të kushtuar prodhimit bujqësor ose blegtoral. Fermeri, si rrjedhojë, është personi fizik që ushtron faktikisht këtë veprimtari ekonomike, jo thjesht dikush që mban një status të regjistruar.

Në bazë të analizës së kuadrit ligjor sipas informacionit të përcjell nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore rezulton se regjistrimi i një personi si fermer me NIPT aktiv rregullohet nga legjislacioni për regjistrimin e subjekteve dhe procedurat tatimore, ndërsa e drejta për përfitimin e pensionit të invaliditetit përcaktohet nga dispozitat e ligjit nr. 7703/1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Sipas interpretimit institucional të ISSH-së, përfitimi i pensionit të invaliditetit lidhet me ekzistencën e humbjes së aftësisë për punë dhe synon zëvendësimin e të ardhurave të munguara për shkak të kësaj paaftësie. Në këtë kuptim, për personat që përfitojnë pension invaliditeti të plotë, të cilët janë vlerësuar nga KMCAP si të paaftë për çdo veprimtari ekonomike, ushtrimi i një aktiviteti ekonomik si i vetëpunësuar paraqet papajtueshmëri me kushtet ligjore mbi bazën e të cilave është njohur përfitimi. Ndërsa, për personat me pension invaliditeti të pjesshëm, ligji lejon vijimin e aktivitetit ekonomik, për sa kohë respektohen kufizimet dhe përcaktimet e vendosura nga KMCAP lidhur me aftësinë për punë, llojin dhe kohën e ushtrimit të veprimtarisë. Për rrjedhojë, vetëm fakti i regjistrimit si fermer me NIPT aktiv nuk është i mjaftueshëm për të përcaktuar ekzistencën e së drejtës për ushtrimin e aktivitetit ekonomik në çdo rast, pasi kjo duhet të vlerësohet në raport me statusin konkret të invaliditetit dhe kufizimet ligjore që rrjedhin prej tij.

Ndërkohë, ligji nr. 7703/1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar, dhe dokumenti i ISSH-së (*publikuar në faqen zyrtare*) e parashikojnë shprehimisht aftësinë për punë si kusht për t'u siguruar si i vetëpunësuar në bujqësi çka nënkupton se z. Xh., teorikisht nuk duhej të ishte i siguruar dhe as fermer i regjistruar nëse ishte i paaftë për punë.

Regjistrimi i fermerit individual bëhet në dy nivele. Së pari, ai pajiset me NIPT nga drejtoria rajonale tatimore. Ky NIPT i fermerit me status aktiv është kushti bazë për të aplikuar në skemat kombëtare të mbështetjes të AZHBR-së. Së dyti, fermeri individual detyrohet të sigurohet shoqërisht si i vetëpunësuar në bujqësi sipas ligjit nr. 7703/1993 “Për sigurimet shoqërore” i ndryshuar, për të cilën skemë ligji kërkon shprehimisht dy kushte kumulative: moshën mbi 16 vjeç dhe aftësinë për punë.

Referuar nenit 5 pika 3 të Kontratës së grantit nr. 280/1 prot., datë 15.01.2025, të lidhur dhe nënshkruar nga vetë ankuesi z. E. Xh., përfituesi ishte i detyruar të përfundonte investimin dhe të paraqiste kërkesën për pagesë së bashku me dokumentacionin e plotë jo më vonë se data 30.06.2025. Duke qenë se kontrata është nënshkruar personalisht nga ankuesi, ai ishte në dëgjim

paraprakisht të të gjitha detyrimeve dhe dokumentacionit të kërkuar për përfitimin e fondit, i cili sipas Udhëzimit nr. 22, datë 19.09.2024 përfshinte: vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria e Tatimeve që vërteton përmbushjen e detyrimeve, vërtetimin për shlyerjen e sigurimeve shoqërore nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore të lëshuar jo më parë se 30 ditë nga data e dorëzimit të kërkesës për pagesë, si dhe vërtetimin e bankës për numrin e llogarisë bankare me firmë dhe vulë të njomë. Për rrjedhojë, mosparaqitja e dokumentacionit të plotë dhe të vlefshëm nuk mund të konsiderohet si rrethanë e paparashikuar nga ankuesi, i cili kishte pranuar dhe nënshkruar shprehimisht të gjitha kushtet kontraktore.

Qëllimi i grantit të akorduar nga AZHBR në kuadër të Masës 12 është financimi i investimeve që shërbejnë për ushtrimin real dhe aktiv të aktivitetit ekonomik bujqësor, dhe jo thjesht blerja formale e një pajisjeje bujqësore.

Fermeri individual, si person i vetëpunësuar dhe operator i vetëm i fermës së tij, duhet të jetë domosdoshmërisht i aftë për punë kërkesë kjo e parashikuar shprehimisht nga ligji nr. 7703/1993 *“Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”*, të ndryshuar, dhe VKM nr. 77, datë 28.01.2015, *“Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”*, e ndryshuar, në pikën “j” të saj është parashikuar se: *“Të vetëpunësuarit në bujqësi, të aftë për punë, që kanë mbushur moshën 16 vjeç, deri në moshën për pension, sipas nenit 92, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”*. Këto akte e përcaktojnë aftësinë për punë si kusht të detyrueshëm për sigurimin e vetëpunësuarit në bujqësi, pikërisht për të mbrojtur fermerin nga aksidentet dhe rreziqet që rrjedhin nga ushtrimi i veprimtarisë bujqësore. Në rastin konkret, z. Xh., mban vendim të përhershëm të KMCAP-it nr. 67, datë 27.02.2020, që e deklaron të paaftë për çdo veprimtari, duke krijuar kështu një papajtueshmëri objektive midis statusit të tij të konfirmuar zyrtarisht dhe qëllimit për të cilin është konceptuar skema e mbështetjes financiare.

Sistemi i sigurimeve shoqërore në Republikën e Shqipërisë, i rregulluar nga ligji nr. 7703, datë 11.05.1993, *“Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, mbështetet mbi parimin kontributiv, sipas të cilit përfitimet financiare kanë për qëllim të zëvendësojnë të ardhurat e humbura si pasojë e pamundësisë për punë. Ky parim përbën themelin e gjithë skemës, duke krijuar një lidhje të drejtpërdrejtë midis kontributeve të paguara, gjendjes së paaftësisë dhe masës së përfitimit. Në këtë kuptim, përfitimi nuk është një e drejtë absolute, por një e drejtë e kushtëzuar nga plotësimi i kriterëve ligjore dhe nga ekzistenca reale e mungesës së të ardhurave për shkak të paaftësisë për punë.

Në mënyrë të veçantë, neni 57 i këtij ligji sanksionon një nga kufizimet kryesore të skemës, duke përcaktuar se përfituesi nuk ka të drejtë të marrë kështu përfitimi për çdo periudhë gjatë së cilës është i punësuar ose ushtron veprimtari ekonomike, qoftë si i punësuar apo i vetëpunësuar. Kjo dispozitë nuk lë hapësirë për interpretim alternativ, pasi synon të shmangë përfitimin e dyfishtë dhe të garantojë që skema të funksionojë mbi bazën e drejtësisë dhe barazisë ndërmjet përfituesve. Vetëm në raste të veçanta, të parashikuara shprehimisht nga ligji, siç është

invaliditeti i pjesshëm, lejohet kombinimi i kufizuar i përfitimit me aktivitetin ekonomik, pikërisht sepse në këto raste personi nuk është plotësisht i paaftë për punë.

Nga ana tjetër, dispozitat e neneve 35 dhe 48 të ligjit përcaktojnë qartë natyrën dhe kushtet e përfitimit të pensionit të invaliditetit të plotë. Sipas këtyre dispozitave, ky pension u takon personave që janë të paaftë për çdo veprimtari ekonomike, pra që nuk kanë mundësi reale për të siguruar të ardhura përmes punës. Ky përcaktim nuk është thjesht formal, por lidhet drejtpërdrejt me vlerësimin mjekësor të bërë nga KMCAP, i cili konstaton shkallën e humbjes së aftësisë për punë. Për rrjedhojë, statusi i invaliditetit të plotë përjashton në mënyrë të qartë dhe të drejtpërdrejtë mundësinë e ushtrimit të një pune të rregullt, pasi vetë përfitimi jepet pikërisht për shkak të pamundësisë për të punuar.

Në këtë kuadër, këto dispozita, të marra së bashku, krijojnë një regjim të qartë juridik: përfitimi i pensionit të invaliditetit të plotë është i lidhur ngushtë me mungesën e aktivitetit ekonomik dhe ndërpritet automatikisht në momentin kur kjo mungesë nuk ekziston më.

Në këto kushte, nga aktet e administruara nuk rezulton që refuzimi i kërkesës për pagesë të jetë bazuar në ndonjë kriter përjashtues të lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të vetme me gjendjen shëndetësore apo aftësinë e kufizuar të ankuesit. Refuzimi është mbështetur, nga njëra anë, në mosplotësimin e kërkesave dokumentare të parashikuara shprehimisht në aktet nënligjore rregulluese të skemës dhe në kontratën e grantit, dhe, nga ana tjetër, në mospërputhjet e konstatuara në dokumentacionin e paraqitur nga vetë ankuesi lidhur me statusin e aftësisë për punë. Për sqarimin e këtyre mospërputhjeve, AZHBR iu drejtua organit kompetent, i cili konfirmoi se vlerësimi i aftësisë për punë është në kompetencë të KMCAP-it dhe se vërtetimi i mjekut të familjes nuk ka vlerë juridike për këtë qëllim, ndërsa statusi i invaliditetit të ankuesit vijon të mbetet në fuqi.

Gjithashtu, në analizën e kuadrit ligjor përkatës të sistemit të sigurimeve shoqërore, rezulton se përfitimi i pensionit të invaliditetit të plotë është i lidhur me pamundësinë për ushtrimin e veprimtarisë ekonomike, duke parashikuar edhe kufizime për përfitimin e të ardhurave në rast të ushtrimit të aktivitetit ekonomik, çka e bën të nevojshme verifikimin e përputhshmërisë së statusit të përfituesit me kërkesat e skemës. Rrjedhimisht, vendimmarrja e AZHBR-së rezulton të jetë pasojë e verifikimeve institucionale të kryera nga organet kompetente dhe e zbatimit të detyrimeve kontraktore e nënligjore të pranuara shprehimisht nga ankuesi me nënshkrimin e kontratës së grantit.

Në vlerësimin e pretendimit të ankuesit për diskriminim për shkak të “gjendjes shëndetësore” dhe “aftësisë së kufizuar”, duhet të mbahet në konsideratë se fakti që një person i përket një kategorie të mbrojtur nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, nuk është në vetvete i mjaftueshëm për të arritur në përfundimin se kemi të bëjmë me diskriminim. Për ekzistencën e diskriminimit kërkohet që trajtimi i pafavorshëm të jetë i lidhur drejtpërdrejt ose tërthorazi me shkakun e mbrojtur dhe që ky shkak të ketë ndikuar në mënyrë përcaktuese në vendimmarrjen e subjektit përgjegjës.

Në rastin konkret, rezulton se ankuesi është person me status invaliditeti dhe për rrjedhojë gjendja e tij shëndetësore dhe aftësia e kufizuar përbëjnë shkaqe të mbrojtura nga ligji nr. 10221/2010. Megjithatë, analiza e dokumentacionit të administruar tregon se refuzimi i kërkesës për pagesë nga AZHBR nuk është bazuar në një përjashtim të përgjithshëm të personave me aftësi të kufizuara nga skemat mbështetëse në bujqësi, por në një vlerësim konkret të përmbushjes së kushteve të përcaktuara për përfitimin e grantit.

Nga aktet rezulton se ankuesi ka aplikuar në kuadër të Masës 12 të Skemave Kombëtare të Mbështetjes, e cila synon financimin e investimeve për mekanizimin dhe modernizimin e proceseve të punës në fermat bujqësore. Kjo skemë nuk krijon një të drejtë automatike për përfitim vetëm mbi bazën e regjistrimit si fermer, por vendos detyrimin që aplikanti të provojë përmbushjen e kriterëve të përcaktuara në aktet rregulluese dhe në kontratën e grantit.

Në këtë kuadër, AZHBR ka kryer një proces verifikimi administrativ të dokumentacionit të paraqitur nga ankuesi. Gjatë këtij procesi është konstatuar se dokumentacioni i depozituar nuk përputhej me kërkesat e skemës, pasi në vend të dokumentacionit të kërkuar lidhur me përmbushjen e detyrimeve për sigurimet shoqërore, ankuesi kishte paraqitur dokumentacion ku rezultonte përfitues i pensionit të invaliditetit urban. Për më tepër, në vijim të procedurës janë paraqitur dokumente me përmbajtje kontradiktore lidhur me aftësinë e tij për punë.

Në kushtet e kësaj kontradikte, AZHBR nuk ka marrë një vendim të menjëhershëm mbi bazën e statusit të invaliditetit, por ka kërkuar informacion nga organet kompetente për të sqaruar gjendjen juridike të ankuesit. Nga përgjigjja e institucionit kompetent rezultoi se statusi i invaliditetit të plotë vijonte të ishte në fuqi dhe se vlerësimi i aftësisë për punë nuk mund të bëhej nga mjeku i familjes, por vetëm nga organet e specializuara ligjore përkatëse.

Në këto rrethana, refuzimi i pagesës nuk rezulton të ketë ardhur si pasojë e faktit që ankuesi ishte person me aftësi të kufizuara, por si rezultat i pamundësisë për të provuar përputhshmërinë e situatës së tij konkrete me kriteret e skemës. Diferenca e trajtimit nuk është krijuar nga statusi i invaliditetit si i tillë, por nga ekzistenca e një situate juridike specifike, ku dokumentacioni zyrtar tregonte një paaftësi të plotë për punë, ndërkohë që përfitimi kërkonte ushtrimin real të një aktiviteti ekonomik bujqësor.

Sa i takon pretendimit për diskriminim indirekt, vlerësohet se një masë ose kriter neutral mund të përbëjë diskriminim indirekt vetëm nëse, megjithëse zbatohet njësoj ndaj të gjithë personave, vendos një kategori të caktuar në një disavantazh të veçantë dhe nuk justifikohet nga një qëllim i ligjshëm ose nuk është proporcional me qëllimin e ndjekur.

Në rastin konkret, kërkesat për dokumentacion, verifikimi i statusit të përfituesit dhe kontrolli i përputhshmërisë me kriteret e skemës janë masa me karakter të përgjithshëm që zbatohen ndaj të gjithë aplikantëve dhe kanë një qëllim të ligjshëm, konkretisht garantimin e përdorimit të fondeve publike vetëm nga subjektet që plotësojnë kushtet e përcaktuara për mbështetjen financiare.

Gjithashtu, nuk rezulton që skema të ketë vendosur një ndalim të shprehur ndaj personave me aftësi të kufizuara. Personat me aftësi të kufizuara nuk përjashtohen si kategori nga mundësia për të aplikuar apo për të përfituar mbështetje financiare. Kufizimi i ardhur në rastin konkret lidhet me situatën individuale të ankuesit dhe me mospërputhjen ndërmjet statusit të tij të konfirmuar zyrtarisht dhe kërkesave që lidhen me përfitimin konkret.

Edhe pretendimi se aktiviteti bujqësor mund të realizohet nëpërmjet punësimit të personave të tjerë nuk ndryshon analizën juridike të çështjes, pasi skema konkrete është konceptuar për përfitues që ushtrojnë aktivitetin ekonomik bujqësor në kuptim të legjislacionit përkatës dhe jo vetëm për persona që zotërojnë mjete apo pajisje bujqësore. Në këtë kuptim, administrata ka të drejtë të kontrollojë nëse përfituesi i fondit përputhet me qëllimin dhe objektivin e masës së mbështetjes.

Nga tërësia e provave dhe rrethanave të administruara nuk rezulton se AZHBR ka zbatuar një kriter të posaçëm përjashtues ndaj ankuesit për shkak të aftësisë së kufizuar. Nuk provohet që një person tjetër në të njëjtat kushte si ankuesi, por pa status invaliditeti, do të ishte trajtuar ndryshe. Për rrjedhojë, mungon elementi i krahasimit dhe lidhja shkakësore e domosdoshme për konstatimin e diskriminimit.

Në përfundim, vlerësohet se vendimmarrja e AZHBR-së ka qenë rezultat i një procedure administrative verifikimi mbi bazën e akteve nënligjore dhe detyrimeve kontraktore të pranuar nga vetë ankuesi, dhe jo rezultat i një qëndrimi diskriminues ndaj tij për shkak të gjendjes shëndetësore apo aftësisë së kufizuar. Për rrjedhojë, nuk provohet ekzistenca e diskriminimit në kuptim të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Në vështrim të përgjithshëm juridik, marrëdhënia ndërmjet skemave të mbështetjes financiare publike në bujqësi dhe përfituesve të tyre karakterizohet nga një regjim i posaçëm administrativ dhe kontraktor, ku e drejta e përfitimit nuk është absolute, por kushtëzohet nga përmbushja kumulative e kriterëve dhe detyrimeve të parashikuara në aktet nënligjore rregulluese dhe në kontratën e grantit. Këto skema nuk krijojnë një të drejtë të pakushtëzuar për pagesë, por një të drejtë të kushtëzuar juridikisht, e cila lind dhe bëhet e ekzekutueshme vetëm pas verifikimit të plotë të përputhshmërisë me kërkesat normative dhe kontraktore të zbatueshme.

Për rrjedhojë, vendimmarrja e AZHBR-së është rezultat i një procesi administrativ të verifikimit të kushteve dhe dokumentacionit të kërkuar nga VKM nr. 130, datë 06.03.2024, Udhëzimi nr. 6, datë 07.03.2024, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 22, datë 19.09.2024, si dhe kontrata e grantit nr. 280/1 prot., datë 15.01.2025, dhe nuk përbën trajtim të ndryshëm të pajustifikuar në kuptim të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Bazuar në tërësinë e arsytimit të mësipërm si dhe në faktet dhe provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se, ankuesi E. Xh., nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë, për rrjedhojë nuk provohet se ka shkelur dispozitat e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32 dhe 33 të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të ankuesit z. E. Xh., në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve, nga Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural , për shkak të “*gjendjes shëndetësore*” dhe “*aftësisë së kufizuar*”.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Genta TAFA (BUNGO)

